

**INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E BONOVE TË THESARIT QË  
APLIKOHEN NGA INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA**

1. Përsa i përket blerjeve të Bonove të Thesarit dhe Obligacioneve në tregun primar (nëpërmjet pjesëmarrjes në ankand), për klientët që aplikojnë nëpërmjet bankës Intesa SanPaolo komisioni është 1.5 o/oo e shumës nominale (komisioni minimal është 1,000 lekë, ndërsa komisioni maksimal është 5,000 lekë). Për klientët që aplikojnë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë (ekzekutimet e veprimeve cash për Bonot e Thesarit) komisioni është 700 Lekë për çdo transaksion.

2. Për blerje të Bonove të Thesarit nga portofoli i bankës ISPA nuk aplikohet asnjë komision. Në këtë rast, klienti do të paguajë shumën që llogaritet në bazë të çmimit të kuotuar për ditët e mbetura deri në maturim.

***Shembull:***

Nëse klienti do të blejë Bono Thesari nga portofoli i bankës për një vlerë nominale 1,500,000 lekë, që maturohet pas 210 ditësh, dhe nëse ISPA shet nga portofoli me 6.9%, çmimi i blerjes së klientit llogaritet si më poshtë:

$$1,500,000 / (1 + 0.069 / 365 * 210) = 1,442,726 \text{ lekë}$$

3. Për shitje të Bonove të Thesarit para datës së maturimit nuk aplikohet asnjë komision. Në këtë rast klienti do të paguajë shumën që llogaritet në bazë të çmimit të kuotuar për ditët e mbetura deri në maturim.

***Shembull:***

Nëse klienti do të shesë Bono Thesari para datës së maturimit për një vlerë nominale 1,500,000 dhe maturohet pas 210 ditësh, dhe nëse ISPA blen me 9.0%, çmimi i shitjes së klientit llogaritet si më poshtë:

$$1,500,000 / (1 + 0.09 / 365 * 210) = 1,426,153 \text{ lekë}$$